

L I G J
Nr.8044, datë 7.12.1995

PËR KONKURRENCËN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA I
OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRCAKTIMET

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të veprimit të pjesëmarrësve në treg dhe i të drejtave e detyrimeve të tyre në kushtet e një konkurrence të drejtë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare financiare e prodhuese brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe për ato që ushtrojnë veprimtari të tilla jashtë këtij territori, por që pasojat e kësaj veprimtarie manifestohen në tregun e brendshëm.

Neni 3
Subjektet

Ky ligj zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, privatë ose shtetërorë, që ushtrojnë veprimtari tregtare financiare e prodhuese, bazuar në parimin e konkurrencës së lirë, që ofrojnë ose kërkojnë mallra, shitblerja ose konsumi i të cilave i nënshtrohet nismës dhe vullnetit të tyre të lirë.

Neni 4
Përcaktimet

Për zbatimin e këtij ligji, termat e mëposhtëm do të kuptohen si vijon:

1. Me “Treg” kuptohet një vend i përcaktuar nga hapësira dhe destinacioni i tij, në të cilin ofrohen dhe kërkohen mallrat që njëkohësisht nga pikëpamja e blerësit apo e ofruesit janë të përafërta e të shkëmbyeshme përsa i përket funksionit, domethënë ato për të cilat gjenden zëvendësues.

2. Me “Konkurrencë” kuptohet veprimtaria që ndikon në shkëmbimin e mallrave nga pjesëmarrës të pavarur në treg, që ofrojnë ose kërkojnë në të njëjtin treg mallra të ndryshme a shërbime me funksion të përafërt përdorimi, për të lidhur me përparësi marrëveshje me blerësit ku mallrat konkurrojnë për shkak të çmimit, sasisë, cilësisë, paketimit, shërbimit, reklamës etj.

3. Me “Shoqëri” kuptohen të gjitha njësitë ekonomike të krijuara në bazë të ligjit, të cilat ofrojnë ose kërkojnë mallra në treg me qëllim fitimi dhe që janë të pavarura e kanë aftësi konkurruese.

Një shoqëri mund të përbëhet nga një a më shumë persona juridikë të pavarur juridikisht dhe që kanë njëkohësisht aftësi të tyre konkurruese, por që bëjnë pjesë në organizimin e përgjithshëm të shoqërisë.

4. Me “Mallra” kuptohen të gjitha sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, shërbimet dhe të drejtat të transferuara që mund të ofrohen ose kërkohen në treg.

5. Me “Monopol” kuptohet situata në treg, kur një pjesëmarrës i vetëm ka në duart e tij shitjen ose blerjen e plotë në një fushë të caktuar.

6. Me “Sundim të tregut” kuptohet ai pozicion në treg ku nuk ka, ose thuajse nuk ka konkurrencë, domethënë sa herë që vendimi për të përfutur ose konsumuar nuk ka ndikim të ndjeshëm në formën e veprimit konkurrues ose nuk është në gjendje ta përcaktojë atë. Studim të tregut kemi në qoftë se një shoqëri e vetme ose një bashkim shoqërisht zotëron më tepër se 40 për qind të tregut.

7. Me “Kufizim horizontal të konkurrencës” do të kuptohet kufizimi që krijohet nga konkurrentë të të njëjtit nivel të qarkullimit ekonomik.

8. Me “Kufizim vertikal të konkurrencës” do të kuptohet kufizimi që krijohet nga konkurrentë të niveleve të ndryshme të qarkullimit ekonomik.

9. Me “Bashkim” do të kuptohet pozita juridike ose faktike e një shoqërie e cila ekziston në rrethanat e mëposhtme:

a) Kur përftohet i gjithë ose një pjesë e konsiderueshme e kapitalit të një shoqërie tjetër si pasojë e shkrirjes, shndërrimit ose në një mënyrë tjetër;

b) Kur përfiton aksione në një shoqëri tjetër, nëse kjo sjell një pjesëmarrje dhe krijon një situatë kontrolli në kuptimin e kreut VI, pjesa II (neni 217-230) të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”;

c) Kur dy shoqëri lidhin një kontratë nëpërmjet së cilës njëra prej shoqërive detyrohet të organizojë biznesin e saj për llogari të shoqërisë tjetër dhe t’i transferojë shoqërisë me të cilën ka lidhur kontratë një pjesë ose gjithë fitimin e saj ose i jep me qira veprimtarinë tregtare një shoqërie tjetër.

d) bashkim krijohet gjithashtu kur të paktën 1/2 e këshillit mbikëqyrës, bordit të drejtorëve ose ndonjë organ tjetër drejtues, i caktuar të drejtojë një shoqëri, është në të njëjtën kohë edhe në organet drejtuese të shoqërisë tjetër.

10. Me “Ndarje të shoqërisë” kuptohet ndarja e një shoqërie në disa pjesë, të cilat fitojnë pavarësi ekonomike, siç parashikohet në kreun VI, seksioni 4 (neni 243 e vazhdim) i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

11. Me “Shoqatë tregtare e profesionale” do të kuptohen bashkimet e lira të pjesëmarrësve aktivë në treg, me qëllim që të nxitin interesat e anëtarëve të tyre.

PJESA II NDARJA DHE NDALIMET E BASHKIMEVE

Neni 5 **Ndarja e shoqërisë**

Shoqëritë tregtare, që ushtrojnë veprimtari ekonomike e që kanë pozitë sunduese në treg, janë të detyruara të ndahen në pjesë të veçanta, në mënyrë të atillë që shoqëritë e pavarura që krijohen fitojnë pavarësi ekonomike dhe ruajnë aftësinë konkurruese të tyre.

Ndarja e shoqërisë realizohet brenda 6 muajve nga dita e vendosjes së ndarjes së shoqërisë si shoqëri sunduese në treg.

Neni 6 **Detyrat e shoqërisë për përgatitjen e ndarjes**

Shoqëritë që kanë pozitë sunduese në treg brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji i paraqesin drejtorisë së konkurrencës ekonomike të dhënat e mëposhtme:

a) Vlerën e përgjithshme të pasurisë, gjendjen financiare, xhiron për 5 vjetët e fundit, numrin e të punësuarve, sasinë e mallrave të hedhura në tregun shqiptar, informacion për lidhjet me pjesëtarë të tjerë në treg, si dhe lidhjet e saj me shoqëri të tjera.

b) Ndarjen organizative në njësi të veçanta, të cilat mund të ekzistojnë si njësi të pavarura në bazë të kriterëve të drejtimit ekonomik. Të dhënat e caktuara në shkronjën “a” të këtij neni i paraqiten drejtorisë së konkurrencës ekonomike edhe për njësitë e veçanta.

Neni 7

Detyrat e drejtorisë së konkurrencës ekonomike për të përgatitur ndarjen

Në bashkëpunim me autoritetet e tjera përgjegjëse për shndërrimin e shoqërive, drejtoria e konkurrencës ekonomike në bazë të të dhënave dhe të hetimeve nga ana e saj, pasi ka marrë më parë edhe mendimin e shprehur nga shoqëria, përcakton masat që duhen marrë për të eliminuar sundimin e tregut, si dhe si do të garantohet pavarësia e pjesëve të shoqërisë dhe shndërrimi i tyre në shoqëri të veçanta.

Neni 8

Realizimi i ndarjes

Ministri që mbulon tregtinë, në bazë të dosjes së përgatitur nga drejtoria e konkurrencës ekonomike, vendos për ndarjen e shoqërisë. Vendimi merret pasi ai më parë ka marrë në konsideratë mendimin e shprehur nga drejtuesi i drejtorisë së konkurrencës ekonomike, si dhe mendimin e shprehur nga përfaqësuesit e shoqërisë.

Neni 9

Paraqitja e kërkesës për bashkim

Për bashkimin e shoqërive të mëdha nevojitet një kërkesë. Kërkesa për bashkim duhet të paraqitet në drejtorinë e konkurrencës ekonomike. Kjo kërkesë duhet të paraqitet vetëm kur pasuria e një prej shoqërive pjesëmarrëse në vitin e fundit financiar arrin një vlerë kontabël jo më pak se 50 milionë lekë ose nëse pasuria e shoqërive pjesëmarrëse në bashkim në vitin e fundit financiar arrin vlerën kontabël në jo më pak se 200 milionë lekë.

Neni 10

Shqyrtimi i kërkesës

Gjatë shqyrtimit të kërkesës drejtoria e konkurrencës ekonomike mban parasysh në mënyrë të veçantë këta faktorë:

- Strukturën e konkurrencës në tregjet e rëndësishme, sidomos të konkurruesve të fuqishëm të vendeve të tjera.
- Pozicionin në treg të shoqërive pjesëmarrëse, si dhe të gjendjes së tyre ekonomike e financiare.
- Mundësitë e zëvendësimit të mallrave nga shitësit dhe blerësit, si dhe mundësitë ligjore për të hyrë në treg.
- Zhvillimin e fuqishëm të progresit teknik, ekologjik dhe ekonomik, kur kjo i shërben interesit publik.

Neni 11

Vendimi për bashkim

Drejtorja e konkurrencës ekonomike është e detyruar që brenda tre muajve nga data e paraqitjes së kërkesës të japë një përgjigje me shkrim nëse e miraton apo jo një bashkim të tillë. Në rast të mungesës së përgjigjes brenda këtij afati bashkimi konsiderohet automatikisht i vlefshëm. Drejtoria e konkurrencës ekonomike mund ta shtyjë këtë afat edhe për tre muaj të tjerë, në rast se shqyrtimi i pasojave në treg ka qenë i vështirë.

Neni 12

Regjistrimi i bashkimit

Bashkimi duhet të regjistrohet në drejtorinë e konkurrencës ekonomike.

Neni 13
Ndalimi i bashkimeve

Drejtoria e konkurrencës ekonomike ndalon bashkimin e shoqërive, kur ky bashkim krijon një pozitë sunduese në treg ose mund ta krijojë së shpejti atë.

Neni 14
Ankesat për refuzimet

Palët pjesëmarrëse, që kanë qëllim të organizojnë një bashkim në rastet kur kërkesa e tyre refuzohet, kanë të drejtë t'i drejtohen me ankim ministrit që mbulon tregtinë i cili, vetëm kur shikon se ka avantazhe të jashtëzakonshme për ekonominë në tërësi ose për interesat publike, mund të pranojë një bashkim të tillë. Kërkesa paraqitet brenda një muaji nga refuzimi i bërë nga drejtoria e konkurrencës ekonomike dhe vendimi për ankesën duhet të merret brenda tre muajve nga paraqitja e saj.

Neni 15
Kushtëzimi për autorizimet

Në vendimet për miratim mund të përfshihen edhe kushtëzime që ulin pasojat e kufizimit të konkurrencës së këtij bashkimi. Mospërbushja e këtyre kushtëzimeve bën që miratimi i dhënë të anulohet.

PJESA III
NDALIMET E KUFIZIMEVE TË KONKURRENCËS

KREU I
**NDALIMET E KUFIZIMEVE HORIZONTALE DHE VERTIKALE
TË KONKURRENCËS**

Neni 16
Ndalimet

Ndalohen kontratat, vendimet, bisedimet dhe procedura të tjera të përcaktuara nga palët, si dhe rekomandime nga konkurrentët që janë në raport horizontal, nivele të njëjta prodhimi, shitje ose kërkesë, të cilat ndikojnë në veprimtarinë ekonomike, duke kufizuar konkurrencën, sidomos në:

- a) caktimet e çmimeve dhe kushteve të tjera të biznesit;
- b) përcaktimet e territoreve të biznesit e të përdoruesve si dhe në ndarjen e tregjeve;
- c) kufizimin ose kontrollin e prodhimit, ofertës ose kërkesës, të zhvillimit teknik dhe investimeve.

Neni 17
Botimi

Ndalimet e kufizimet e konkurrencës duhet të botohen nga ana e drejtorisë së konkurrencës ekonomike, duke shprehur në të njëjtën kohë edhe arsyet. Ato duhet të regjistrohen në një regjistër të hapur për publikun, i cili mbahet nga drejtoria e konkurrencës ekonomike.

Neni 18
Sigurimi i kufizimeve të konkurrencës horizontale

Ndalohen marrëveshjet, kontratat, bisedimet dhe procedurat ndërmjet shoqërive që janë në raport vertikal e në nivele të ndryshme shitjesh që synojnë të mbështetin kufizimet horizontale të paligjshme të konkurrencës. Veprime të tilla janë të pavlefshme.

Neni 19

Imponimi për caktimin e çmimeve dhe rekomandimi për to

1 Ndalohet marrëveshjet, kontratat dhe praktikat ndërmjet shoqërive, në rast se ato imponojnë kufizime ndaj një pjesëmarrësi për caktimin e çmimeve në kontratë dhe të kushteve të tjera me partnerë të tretë.

2 Në bazë të kërkesës drejtoria e konkurrencës ekonomike mund të bëjë përjashtim për botimet.

Neni 20

Marrëdhënie ekskluziviteti

Marrëdhëniet kontraktuese janë të pavlefshme në qoftë se:

- a) ato i kufizojnë një palë në kontratë lirinë e vet për të përpunuar ose shitur mallra.
- b) ato i kufizojnë një palë në kontratë lirinë e vet për të blerë ose shitur mallra nga një ose disa palë të tjera.
- c) ato përmbajnë një detyrim për një palë në kontratë për të koordinuar livrimin e mallrave të papajtueshme me interesat e palës tjetër;
- d) krijohet ose forcohet sundimi i tregut nga njëra prej palëve në kontratë;
- e) tregu për mallra të zëvendësueshme në përdorim është i mbyllur për të jashtëm dhe nuk ka mundësi për zëvendësim produktesh;
- f) konkurrenca në treg për produkte të zëvendësueshme në përdorim është dëmtuar rëndë dhe nuk kompensohet siç duhet me favore të ndaj konsumatorit.

Neni 21

Kontratat për përdorimin e pronësisë industriale

1. Ndalohet mbajtësi i patentave dhe markave e know-how-t që të bjerë dakord qoftë vetë ose në bashkëveprim me të tjerë, për të kufizuar konkurrencën në marrëveshje për përdorimin e këtyre të drejtave, të cilat tejkalojnë kushtet në marrëveshje. Një gjë e tillë lejohet deri në mbrojtje të ekskluzivitetit, por jo kur e kalon atë.

2. Ndalohet të arrihen marrëveshje për kufizime në përdorimin e pronësisë industriale, të cilat zgjatin më tepër se periudha e caktuar për mbrojtjen e patentës. Kontratat për njohuritë e panjohura me ligj nuk mund të bëhen për një kohë më të gjatë se 10 vjet.

Marrëveshje të tilla, në rast se arrihen, janë të pavlefshme.

Neni 22

Detyrimi për kontratë të rregullt

Çdo mbajtës i së drejtës së pronësisë industriale Know-how, i cili ka lidhur një marrëveshje që ndalohet me ligj, detyrohet të pranojë ofertat për të hyrë në marrëveshje të rregullt për kalimin e të drejtave të tij në kushte të rregullta të tregut.

Neni 23

Përjashtimet për kufizimet

Pranohen kufizimet që përcaktohen në marrëveshje nga mbajtësi i së drejtës së pronësisë industriale Know-how, të cilat lidhen me ekskluzivitetin, territorin ku do të përdoret, kohën, sasinë dhe qëllimin e ushtrimit të të drejtave. Pranohet gjithashtu marrëveshja për kontrollin e cilësisë dhe detyrimet e ndërsjella për shkëmbim përvoja deri në dhënien e licencës për zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës që është objekt i kontratës.

KREU II RREGULLAT E KONKURRENCËS

Neni 24

Procedura për rregullat e konkurrencës

Shoqatat tregtare dhe ato profesionale hartojnë rregullat e konkurrencës, të cilat miratohen dhe regjistrohen në regjistrin e rregullave të konkurrencës që mbahen nga drejtoria e konkurrencës ekonomike. Në regjistër përfshihen gjithashtu edhe të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e mëvonshme. Rregullat e konkurrencës, ndryshimet dhe shfuqizimet e bëra botohen rregullisht. Për rastet kur shoqatat tregtare dhe profesionale kërkojnë shfuqizimin e këtyre rregullave, drejtoria e konkurrencës ekonomike i shfuqizon ato pa ndonjë pretendim të mundshëm.

Neni 25

Dëgjimi i konkurrentëve dhe i ekspertëve për regjistrim

Përpara regjistrimit drejtoria e konkurrencës ekonomike dëgjon ekspertët dhe konkurrentët furnizues dhe blerës të tjerë, si dhe shoqata të profesionit të ndryshëm, të cilat nuk kanë marrë pjesë në hartimin e rregullave të konkurrencës.

Neni 26

Qëllimi i rregullave të konkurrencës

Drejtoria e konkurrencës ekonomike i paraqet shoqatave tregtare dhe profesionale rregullat, me qëllim që të orientojë veprimtarinë e shoqërive, të përcaktojë qëndrimet e tyre lidhur me konkurrencën, në mënyrë që konkurrenca të funksionojë normalisht mbi bazën e dispozitave ligjore dhe njëkohësisht të mbrohet e drejta e konsumatorëve.

PJESA IV

VEPRIMET NË KUNDËRSHTIM ME KONKURRENCËN

KREU I

NDALIMET PËR VEPRIME TË PALIGJSHME TEK KONSUMATORËT

Neni 27

Mashtrimi

1. Ndalohet përdorimi i mjeteve të komunikimit për të transmetuar të dhëna gojore dhe shkresore, të cilat japin një paraqitje jo të vërtetë tek personat, të cilëve u adresohet, duke ndikuar kështu në qëndrimin e tyre.

2. Ndalohet mashtrimi nëpërmjet deklaratave, të cilat fshehin informacione të rëndësishme që krijojnë një paraqitje jo të vërtetë për mallrat.

3. Ndalohen gjithashtu rastet kur konkurruesit fshehin pozicionin e tyre të dyfishtë dhe kryejnë tregti direkte të fshehtë, me qëllim që të krijojnë avantazhe të paligjshme, duke mos respektuar rregullat e konkurrencës. Për të përcaktuar nëse ka mashtrim, duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat dhe të dhënat e veprimtarisë.

4. Sipërmarrësit duhet të sigurojnë në çdo rast të dhënat faktike, ku mbështesin informacionin e tyre.

5. Ndalohet përhapja e të dhënave të gabuara që kanë për qëllim përfitimin nga konkurrenca, siç janë të dhënat:

- për pasuritë e paluajtshme dhe mundësitë e përdorimit të tyre.
- për karakteristikat, pjesët përbërëse, vlefën ose cilësi të tjera të mallit.
- për sasinë dhe peshën e mallrave.
- për çmimin, marrëdhëniet e tij me tregun dhe uljen e çmimeve.
- për kushtet që janë objekt i livrimit ose shërbimit të parashikuar, veçanërisht dhënien e

garancive.

- për mundësinë e përdorimit të mallrave të ofruara.
 - për identitetin e furnizuesit, aksionet e tij, cilësimin i tij ose çmimet që i janë dhënë atij ose produkteve të tij.
 - për cilësimin e personave, rekomandimet e të cilëve sipërmarrësi i paraqet si vlerësim.
6. Sipërmarrësi duhet të jetë i aftë të vërtetojë deklaratat e bëra në reklamën e tij.

Neni 28

Përfitimi nga emri i mirë

Ndalohen të përdoren emërtime në veprimtarinë e biznesit, të cilat krijojnë përshtypjen se mallrat e emërtuara kështu kanë origjinë nga një vend, territor ose qytet i caktuar, sidomos kur kjo shkakton përshtypjen e një cilësie ose karakteristike të veçantë. Kjo nuk zbatohet për emërtime që përgjithësisht përdoren në transaksione tregtare, me qëllim që të tregohet tipi ose cilësia e mallrave, përderisa kjo nuk jep përshtypjen si deklaratë origjinë.

Neni 29

Detyrimi i emërimit, çmimit dhe etiketimit

1. Furnizuesit janë të detyruar të përcaktojnë çmimin me pakicë në lekë, qartë dhe pa mëdyshje.
2. Kur është e rëndësishme të krahasohen çmimet ndërmjet furnizuesve, mallrat e ambalazhuara duhet të tregojnë sasinë dhe peshën neto, peshën në njësinë e matjes së përdorshme dhe të vlefshme në Republikën e Shqipërisë.
3. Furnizuesit janë të detyruar të japin udhëzime me shkrim për mënyrën dhe afatet e përdorimit të mallrave kur ato janë të një rëndësie të veçantë dhe paraqesin rreziqe për shëndetin.

Neni 30

Ndalimi i reklamës së fshehtë dhe reklamës krahasuese

1. Ndalohet përdorimi në organet e masmedias i informacionit që fsheh një reklamë të mallit.
2. Ndalohet reklama krahasuese kur ajo nuk është e plotë dhe e verifikueshme.

Neni 31

Presioni fizik ose psikologjik

1. Ndalohet ushtrimi i presionit fizik ose psikologjik, në mënyrë që t'i imponojnë të interesuarit të hyjnë në një transaksion.
2. Ndalohet presioni psikologjik që ushtrohet nëpërmjet reklamës, që ndërhyr në jetën private dhe që në përgjithësi ndihet si dëm ndaj interesave të shoqërisë tregtare, si dhe nga dërgimi i mallrave jo sipas kërkesës dhe imponimi për shitjen e tyre.

Neni 32

Shfrytëzimi i mungesës së përvojës

Ndalohet të përdoret reklamë ose metoda shitjeje, të cilat shfrytëzojnë besimin ose mungesën e përvojës së blerësve, në veçanti të fëmijëve dhe të rinjve, në një mënyrë që çorienton vëmendjen nga thelbi i sendit në transaksionin e shitjes.

Neni 33

Dhuratat

Ndalohet t'i jepen përdoruesve dhurata, objekte me vlerë ose të bëhen ulje çmimesh, të cilat tejkalojnë standartet normale në tregti, në mënyrë që t'i detyrojnë ata t'i blejnë, duke bërë që të

krijohet rreziku i mashtrimit për çmimin e mallrave të ofruara ose për mallrat e tjera të ofruara nga furnizuesi.

Neni 34

Shfrytëzimi i dobësisë për lojë

1. Ndalohet që të shfrytëzohet dobësia e përdoruesit për qëllime të nxitjes së shitjeve, duke organizuar lojëra fati ose llotari të jashtëligjshme, të cilat mashtrojnë publikun, krijojnë presion psikologjik për të blerë, tërheqin vëmendjen nëpërmjet avantazheve disproporcionale, ose i organizojnë lojërat e fatit me kusht për të bërë shitje.

2. Ndalohet të shfrytëzohet ose të krijohet frikë ose supersticion, me qëllim që të nxitet shitja dhe të zhvendoset vëmendja nga arsyet thelbësore, të cilat ndikojnë në vendimin e blerjes.

Neni 35

Tërheqja e padrejtë e konsumatorëve

Ndalohet të përdoren persona joaktivë në tregti, me qëllim që të nxitet shitja, duke shfrytëzuar marrëdhëniet personale me familjarë ose miq për të bërë ose krijuar transaksione tregtare.

Neni 36

Krijimi i situatës së mungesës

1. Ndalohet të kërkosh ose të bësh pagesa për mallra me çmim të lartë si rezultat i kufizimit në konkurrencë ose shfrytëzimit të një pozicioni ekonomik të fuqishëm.

KREU II

NDALIMET PËR VEPRIME TË PALIGJSHME TE KONKURRENTËT

Neni 37

Pengesat e shitjeve, blerjeve ose reklamës

Ndalohet mënjanimi ose përpjekja për mënjanimin e konkurrentëve nga shitja, blerja dhe reklama, me qëllim që të fitosh një avantazh në konkurrencë, duke mos i dhënë mundësi përdoruesve të bëjnë krahasim për mallrat.

Neni 38

Shqetësimi për veprime

Ndalohet të ndërhysh pa arsye në biznesin e një konkurrenti dhe të krijosh shqetësime në prodhimin ose veprimet e shitjeve, me qëllim që të fitohet një avantazh në konkurrencë.

Neni 39

Çmimet e ulëta, shpërndarjet masive

1. Ndalohet fitimi i një avantazhi në konkurrencë duke ulur çmimet, kur qëllimi kryesor është të nxirren jashtë tregut konkurrentët ose të shkatërrohen ata, ose kur këto shoqërohen me mashtrimin e blerësve.

2. Ndalohet shpërndarja masive falas e mallrave konkurruese, me qëllim që të fitohen avantazhe në konkurrencë.

Neni 40

Bojkotimi

Ndalohet t'u kërkohet të tjerëve që të ndërpresin marrëdhëniet e biznesit me një palë të tretë ose të mos hyjnë në marrëdhënie biznesi për livrimet dhe blerjet, pa ndonjë shkak dhe me qëllim që të

fitohet një avantazh në konkurrencë.

Neni 41

Diskriminimi i konkurrentëve, blerësve dhe livruesve

1. Shoqëritë që kanë pozicion sundues në treg ndalohet të shfrytëzojnë pozicionin e tyre për pranimin e kërkesave dhe ofertave me qëllim që të pengojnë direkt ose indirekt konkurrentët e tjerë.

2. Diskriminim të konkurrentëve kemi kur:

- imponohen çmime të ulura a të larta, ose këto çmime përdoren në mënyrë diskriminuese me tregtarë të ndryshëm në tregje që krahasohen si të njëjta;

- kufizohet prodhimi, shitjet dhe zhvillimi teknik,

- lidhja e kontratave kushtëzohet me pranimin e shërbimeve ekstra që nuk kanë të bëjnë me kontratën dhe as janë në përputhje me praktikën tregtare.

3. Ndalohet trajtimi i diferencuar i blerësve ose furnitorëve që bazohet në mashtrim, edhe kur ka pozicion dominues në treg.

4. Drejtoria e konkurrencës ekonomike me nismën e saj, ose me kërkesën e një konkurenti apo shoqate profesionale tregtare të ndalojë mashtrimin dhe t'i kërkojë gjykatës kompetente që kontratat të deklarohen të pavlefshme.

Neni 42

Dëmtimi i një biznesi - Prishja e reputacionit

Ndalohet të bëhen ose të qarkullohen deklarata të falsifikuara në tregti për veprimet tregtare të një tregtari tjetër, për pronarin, drejtuesin e shoqërisë ose mallrat e tij, të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e tyre.

KREU III ABUZIMET

Neni 43

Shtyrja në gabim

1. Ndalohet që në veprimtarinë tregtare të përdoren simbole ose përshkrime të tjera që mund të krijojnë konfuzion për një konkurrent ose prodhimet e tij. Kjo zbatohet në veçanti për emrin e një shoqërie ose për dizenjon e produkteve a shërbimeve që shikohen si karakteristikë e një shoqërie tregtare ose produkti të veçantë.

2. Në përcaktimin e rrethanave të shtyrjes në gabim duhet të mbahen parasysh të gjitha rrethanat, siç janë: ngjashmëria me markat tregtare, produktet, fusha e veprimtarisë së konkurrentëve, afërsia e tyre lokale, si dhe shkalla e afërsisë dhe kohëzgjatja e përdorimit.

Neni 44

Imitimi dhe marrja e rezultateve

Ndalohet që në veprimtarinë tregtare të imitosh produktet e gatshme të një pale të tretë me qëllim imitimi, ose me qëllim që të kursehen shpenzime e përpjekje të konsiderueshme, duke dashur që të fitohen avantazhe në konkurrencë.

Neni 45

Shkelja e moralit dhe e ligjit

Ndalohet të përdoren reklama, të cilat janë kundër dinjitetit njerëzor dhe primeve të moralit.

Ndalohet të fitosh një avantazh konkurrence duke shkelur me ndërgjegje rregullat dhe ligjet.

Neni 46
Korrupsioni

Ndalohet të fitohet një avantazh konkurrence nëpërmjet akrobllëkut ose korrupsionit.

Neni 47
Tërheqja e klientëve

Ndalohet të krijosh situata që një përdorues të ndërpresë kontratën me një person fizik a juridik tjetër me qëllim që të përfundosh një kontratë me përdoruesin dhe të fitosh një avantazh në konkurrencë.

Ndalohet të shfrytëzosh në mënyrë të pandershme një prishje kontrate të një pale të tretë, me qëllim që të fitosh një avantazh në konkurrencë.

Neni 48
Tërheqja e nëpunësve

Ndalohet të shkaktosh prishjen e kontratës nga të punësuarit me një punëdhënës konkurrent, në mënyrë që t'i punësosh ata duke fituar një avantazh në konkurrencë.

Neni 49
Mbrojtja e sekreteve të biznesit

1. Ndalohet sigurimi i sekreteve të biznesit ose i atyre të veprimtarisë operative të konkurrentëve në rrugë të paligjshme ose duke nxitur të punësuarit e tij, me qëllim që t'i përdorësh ose t'i shesësh ato.

2. Ndalohet t'u japësh të tjerëve ose të përdorësh sekrete biznesi ose të veprimtarisë operative, njohuri të cilat janë siguruar gjatë marrëdhënies së punësimit ose marrëdhënies të tjera konfidenciale, me qëllim që të fitohen avantazhe në konkurrencë për vete ose për një palë të tretë, ose të dëmtohet pronarin e një shoqërie tregtare. Ky detyrim është maksimumi për një periudhë dyvjeçare, pas përfundimit të punësimit ose marrëdhënies konfidenciale, në qoftë se pronari i veprimtarisë së biznesit ka një interes të justifikuar për këtë veprimtari dhe në qoftë se kjo nuk të çon në kufizim të paarsyeshëm të biznesit ose veprimtarisë profesionale të të tjerëve.

Neni 50
Konkurrenca e pandershme e nëpunësve

1. Të punësuarit i ndalohet të ushtrojë një veprimtari ekonomike konkurruese ndaj punëdhënësit për llogari të tij, ose për llogari të një pale të tretë, gjatë periudhës së punësimit të tij, pa pëlqimin e punëdhënësit. Në rast shkeljeje punëdhënësi mund të përfundojë marrëdhënien e punësimit pa ndonjë njoftim të mëparshëm.

2. Pëlqimi sipas paragrafit të parë duhet të jepet në qoftë se punëdhënësi ka pasur dijeni për veprimet konkurruese të të punësuarit në kohën e lidhjes së kontratës së punësimit dhe përfundimi i saj nuk është përcaktuar shprehimisht.

3. Lejimi i ushtrimit të një veprimtarie konkurruese kundrejt punëdhënësit, pas përfundimit të marrëdhënies të punës, bazohet në marrëveshjet e bëra në kontratën e punësimit. Këto duhet të marrin në konsideratë interesat e justifikuara të punëdhënësit, si dhe interesat e të punësuarit në një veprimtari të lirë profesionale dhe të biznesit. Në rast se është arritur një marrëveshje e tillë, punëdhënësi duhet të kompensojë të punësuarin për disavantazhet financiare pas përfundimit të marrëdhënies të punësimit.

4. Një i punësuar në shoqëri shtetërore ose administratën shtetërore nuk mund të jetë aksionar në një shoqëri private ose anëtar i bordit drejtues, ose mbikëqyrës i një shoqërie të tillë, në rast se kjo mund ta pengojë atë në plotësimin me ndërgjegje të detyrave ose mund të krijojë konflikt interesash.

KREU IV
PËRJASHTIMET NGA ZBATIMI I DISA DISPOZITAVE

Neni 51

Përfjashtimet për sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe atë ushqimor

Nenet 16, 18 e 19 nuk zbatohen për kontratat, veprimtaritë e tjera të përbashkëta dhe rekomandime të prodhuesve e shoqatave ndërmjet tyre ose shoqërive të tjera, përderisa ato kanë të bëjnë me prodhimin, shitjen, magazinimin, përpunimin e produkteve bujqësore dhe pyjore pa fiksuar çmimin.

Marrëveshja përkatëse ose rekomandimi do t'i paraqiten menjëherë drejtorisë së konkurrencës ekonomike.

Neni 52

Përfjashtimet për sektorin e shërbimeve publike

1. Nenet 5, 9 e 15 nuk zbatohen për shoqëritë e shërbimit publik, në veçanti për energjinë elektrike, gazin dhe ujin, përderisa ato furnizohen nëpërmjet linjave ose tubacioneve me instalime të fiksuara.

2. Nenet 16, 18 dhe 19 në kuptim të paragrafit 1 nuk zbatohen për kontratat e lidhura ndërmjet shoqërive të shërbimit publik ose kontratat e lidhura me autoritetet rajonale a lokale, përderisa me këto kontrata janë ndarë rajonet e shpërndarjes dhe marrëveshja ndërmjet tyre lidhet me shpërndarjen territoriale, ekskluzivitetin e livrimit e furnizimit ose fiksimit e çmimit që miratohet nga autoritetet mbikëqyrëse ose rregulluese.

3. Kontratat me përmbajtjen e përcaktuar në paragrafin 2 duhet të regjistrohen në drejtorinë e konkurrencës ekonomike. Në kohën e regjistrimit duhet të sillet prova që tregon se kontrata ose mënyra e organizimit të tyre nuk përmbajnë abuzim të pozicionit të tyre në treg, të arritur si rezultat i përfjashtimit dhe në veçanti nuk kanë më tepër kushte të pafavorshme për konsumatorët se ato për rastin e konkurrencës ekzistuese.

Neni 53

Përfjashtimet për disa shoqëri transporti

1. Nenet 5, 9-16, 18 e 19 nuk zbatohen për telekomunikacionin dhe hekurudhën ose shoqëritë e tjera të aviacionit dhe shoqëritë detare, në rast se parashikohet që çmimet e tyre ose kushtet e tjera kontraktore kërkojnë një miratim publik, ose në qoftë se veprimtaria e tyre i kalon kufijtë kombëtarë.

2. Nenet 5, 9-16, 18 e 19 nuk zbatohen për shoqëritë që kryejnë transportin e pasagjerëve, në qoftë se ato i shërbejnë interesave publike për ngritjen dhe mbajtjen e linjave të trafikut dhe kufizimet bëhen të domosdoshme për shërbim publik normal. Kufizimet hynë në fuqi mbas regjistrimit në drejtorinë e konkurrencës ekonomike.

Neni 54

Përfjashtimi për bankat dhe sigurimet

1. Ky ligj nuk zbatohet për Bankën e Shqipërisë.

2. Nenet 16, 18 e 19 nuk zbatohen për kontratat, veprimet e tjera të përbashkëta dhe rekomandimet e instituteve financiare ose shoqëritë e sigurimit, në qoftë se këto kontrata lidhen me biznese që janë objekt i miratimit ose kontrollit nga organe shtetërore për sektorët bankarë ose të sigurimit. Me qëllim që të jenë të vlefshme, këto kontrata duhen të regjistrohen në drejtorinë e konkurrencës ekonomike.

Neni 55

Përfjashtimi për shoqëritë e të drejtës së autorit

Nenet 5, 9-16, 18 e 19 nuk zbatohen për krijimin e shoqërive të së drejtës së autorit dhe për

kontratat, veprimet e tjera të përbashkëta ose rekomandimet e shoqërive të tilla, të cilat kufizojnë konkurrencën për aq kohë sa ekzistojnë në bazë të legjislacionit.

Me qëllim që të jenë të vlefshme, këto kontrata duhet të regjistrohen në drejtorinë e konkurrencës ekonomike.

Neni 56

Kontrolli i praktikave abuzive

1. Në qoftë se drejtoria e konkurrencës ekonomike vërteton një abuzim në përjashtimin nga detyrimet që përcaktohen në këtë ligj, ajo mund të detyrojë shoqëritë që përfshihen në të, të ndalojnë abuzimin ose të ndryshojnë kontratat ose veprimet e tyre të përbashkëta, ose mund t'i drejtohen gjykatës kompetente për të deklaruar kontratat si të pavlefshme.

2. Pavarësisht nga periudha e tyre e vlefshmërisë, pas kalimit të 10 vjetëve kontratat e regjistruara do t'i nënshtrohen shqyrtimit të rrethanave aktuale nga shoqëritë pjesmarrëse, drejtoria e konkurrencës ekonomike, organet e mbikëqyrjes tregtare dhe palët e tjera të interesuara, dhe në qoftë se është e nevojshme kontratat të përshtaten në rrethanat e ndryshuara.

PJESA V

DREJTORIA E KONKURRENCËS EKONOMIKE

Neni 57

Drejtoria e konkurrencës ekonomike

Për mbrojtjen e konkurrencës krijohet drejtoria e konkurrencës ekonomike, e cila është një institucion publik në varësi të ministrit që mbulon tregtinë dhe drejtohet nga një drejtor i përgjithshëm.

Qendra e saj është në Tiranë. Ajo mund të ketë degë në qytete të tjera të Shqipërisë. Degët në rrethe kanë detyrë të merren ekskluzivisht me probleme të rrethit të tyre, ndërsa problemet që lidhen me gjithë vendin ose me jashtë janë kompetencë e drejtorisë qendrore në Tiranë.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të përcaktojë dispozita të veçanta për funksionimin e drejtorisë së konkurrencës ekonomike.

Neni 58

Juridiksioni

Drejtoria e konkurrencës ekonomike ka në juridiksionin e saj:

- nxitjen e konkurrencës ekonomike;
- mbrojtjen e kufizimeve ose përjashtimeve nga konkurrenca;
- dhënien e miratimeve të kërkuara, si dhe refuzimet përkatëse deri në ato që i janë rezervuar ministrit që mbulon tregtinë;
- konstatimin e shkeljeve dhe kufizimeve ndaj konkurrencës;
- përfaqësimin në bisedime e marrëveshje të ndryshme me institucione analoge të vendeve të tjera;
- kontrollin e subjekteve për zbatimin e këtij ligji, si dhe gjobitjen e mundshme të tyre;
- veprimet për pavlefshmërinë e akteve të ndryshme në kuadrin e konkurrencës së pandershme;
- nxjerrjen e urdhrave për derdhjen e përfitimeve të padrejta në buxhetin e shtetit;
- analizat e tregut dhe botimet e raporteve vjetore për strukturën e tregut në Shqipëri;
- botimin e të dhënave për miratimin e marrëveshjeve, ndarjeve, bashkimeve, shpërdorimin e pozicionit sundues, si dhe për gjobat e vëna.

Drejtoria e konkurrencës ekonomike mund të urdhërojë zbatimin e masave të menjëhershme, kur këtë e kërkon shëndeti i popullit, çështje të tjera publike ose interesa ekonomike.

Neni 59

Kompetenca për shqyrtimin e fakteve

1. Për kryerjen e detyrave të saj, drejtoria e konkurrencës ekonomike mund:
 - a) të kërkojë informacion nga firmat, bizneset, shoqëritë dhe palë të tjera për marrëdhënie ekonomike, ligjore dhe organizative, si dhe të marrë një informacion të tillë mbi të njëjtat çështje nga të tretët;
 - b) të kontrollojë dokumentet e biznesit të firmave, të bizneseve, shoqërive dhe palëve të tjera në proces e sipër;
 - c) të shqyrtojë dokumentet e marra si rezultat i inspektimit të bërë prej saj ose t'ia japë për shqyrtim një palë të tretë.
2. Aktet që tregojnë masat e treguara në nenin 58 duhet të specifikojnë bazën ligjore, qëllimin, objektin dhe fushën e zbatimit të veprimit të kërkuar.
3. Për qëllimin e kryerjes së masave të parashikuara në nenin 58, firmat, bizneset, shoqëritë dhe palë të tjera të përfshira duhet të lejojnë ekzaminimin e dokumenteve dhe futjen në të gjitha selitë e biznesit gjatë orëve të punës dhe në rast vonese për shqyrtimin, lejojnë që të bëhen ekzaminime të tilla edhe në kohë të tjera.
4. Kontrollat e selive të biznesit dhe marrja e dokumenteve kërkojnë urdhër paraprak të gjykatës. Në rast vonese të këtij urdhri, kontrolli dhe marrja e dokumenteve lejohen pa urdhrin e gjykatës. Në këtë rast urdhri i gjykatës duhet të merret pa vonesë, pas zbatimit të masave. Në çdo rast kontrolli dhe marrja duhet përpiluar një raport.
5. Njohuritë e fituara dhe dokumentet e arritura si pasojë e masave, siç përcaktohet në nenin 58, mundet të përdoren vetëm për procedurat e lëna pezull. Dokumentet, mostrat e produkteve etj. duhet të ruhen me kujdes nga drejtoria e konkurrencës ekonomike dhe të kthehen në fund të procedurës. Nëse nuk është e mundur të kthehen, duhet bërë kompensimi për çdo dëm që mund të ketë ndodhur.

Neni 60

Procedurat e drejtorisë së konkurrencës ekonomike

1. Drejtoria e konkurrencës ekonomike e fillon veprimtarinë e saj në bazë të një kërkesë. Të drejtën për të bërë kërkesë e kanë tregtarët, konsumatorët dhe shoqatat e tyre, kur ato mund të jenë të interesuara.
2. Nëse drejtoria e konkurrencës ekonomike vendos të ndërmarrë një proces, ajo duhet të njoftojë me shkrim pa vonesë personat e prekur, si dhe kërkuar dhe t'u japë atyre mundësinë të bëjnë deklaratë.
3. Vendimi merret mbi bazën e procedurës gojore. Me kërkesën e palës së dëmtuar dhe pëlqimin e palës tjetër, mund të merret një vendim dhe pa procedurën gojore.
4. Drejtoria e konkurrencës ekonomike mund të lejojë një pjesëmarrje të kufizuar nga publiku, kur ka arsye për t'u trembur nga ndonjë zbulim i paautorizuar i sekreteve të biznesit apo të firmës së njëres prej palëve.
5. Në raste veçanërisht urgjente, vendimi mund të shpallet edhe pa një shqyrtim publik ose gojor të çështjes.
6. Vendimi i drejtorisë së konkurrencës ekonomike jepet me shkrim dhe argumentohet.
7. Drejtoria e konkurrencës ekonomike mund të vendosë që vendimi i saj të publikohet në mënyrë të arsyeshme dhe shpenzimet t'i mbulojë personi që ka thyer ligjin.

Neni 61

Ankimet në gjykatë

1. Kundër vendimit të drejtorisë së konkurrencës ekonomike ose të ministrit mund të bëhet ankim.
2. Ankimet duhet të paraqiten në gjykatën kompetente brenda një muaji.
3. Gjykata vendos për pranimin ose jo, tërësisht ose pjesërisht të kërkesës.
4. Palët që marrin pjesë në procesin gjyqësor janë:
 - a) drejtoria e konkurrencës ekonomike;
 - b) organi vendimi i të cilit kundërshtohet;
 - c) subjekti që ka paraqitur kërkesën.

5. Në procesin gjyqësor gjejnë zbatim dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

PJESA VII TË DREJTAT E PALËVE

Neni 62

Kërkesa për kompensim

1. Konkurrentët, furnizuesit dhe konsumatorët ose palë të tjera, interesi ekonomik i të cilave është dëmtuar si rezultat i veprimeve që ndalohen nga ky akt ose që shpallen si të paligjshme, mund të ngrenë një kërkesë për shpërblim dëmi.

2. Shuma e kërkesës për shpërblim dëmi caktohet nga gjykata në bazë të gjykimit, pasi të jenë marrë në konsideratë të gjitha rrethanat.

3. Kërkesa për kompensim parashkruhet në qoftë se personi i dëmtuar nuk e kërkon këtë sipas dispozitave të Kodit Civil.

4. Pronari i firmës përgjigjet për veprimet e të punësuarve të vet dhe agjentëve të vet si për veten e tij.

Neni 63

Kërkesa për ndalimin e qëndrimit dhe eliminimin e pasojave

1. Konkurrentët, furnizuesit, konsumatorët dhe blerës të tjerë, si dhe shoqatat e tyre profesionale përkatëse, mund të padisin në gjykatë drejtpërdrejt, me qëllim për të anuluar kufizime ndaj konkurrencës ose për të rivendosur ndershmërinë e konkurrencës, nëse drejtoria e konkurrencës ekonomike vendos të mos veprojë në bazë të kërkesës ose në qoftë se ajo nuk e ka njoftuar personin që ka bërë kërkesë brenda tri ditëve.

2. Padia mund të ketë objekt ndalimin e qëndrimit të paligjshëm, revokimin e qëndrimit ose veprimit, një përgënjeshttrim apo një deklaratë për pavlefshmërinë e kontratës.

Neni 64

Kompetencat

Për paditë në bazë të neneve 62 e 63 janë kompetente gjykatat e rretheve, që i kanë zyrat e tyre në të njëjtin vend me degën përkatëse të konkurrencës ekonomike.

Neni 65

Mbrojtja ligjore e përkohshme

Në qoftë se mbrojtja e interesave publike ose e palëve kërkon një vendim të shpejtë, mund të fillojnë procedurat duke marrë një vendim të ndërmjetëm.

Neni 66

Zbatimi i rregullave të tjera

Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile gjejnë zbatim edhe për procedurat e përcaktuara në pjesën VI.

PJESA VII SANKSIONET

Neni 67

1. Sanksione jo më pak se 10 000 lekë dhe jo më shumë se 200 000 lekë do të zbatohen për shoqëritë që shkelin nenet 16, 40, 43-50.

2. Sanksione jo më pak se 40 000 dhe jo më shumë se 500 000 lekë do të zbatohen kur:

- shkelja për rastet e përcaktuara në paragrafin e parë përsëritet pa kaluar tre vjet.
- shkeljet kanë pasur si rezultat pasoja tepër të dëmshme në tregti, te konsumatorët dhe në ekonominë kombëtare.

3. Individët që kanë shkelur ose që kanë lejuar shkeljen, në rastet kur shkelja e tyre nuk përbën vepër penale, do të paguajnë një sanksion deri në 30 000 lekë. Gjopa dhe sanksione do të paguajnë dhe drejtorët e përgjithshëm ose drejtorët e shoqërive, në qoftë se personalisht do ta shkelin këtë ligj.

Neni 68

Përgjegjësia penale

Në rastet kur shkelja e ligjit është bërë me qëllim dhe nga kjo rezultojnë pasoja të rënda për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit ose interesave të rëndësishme ekonomike e të pronës, atëherë shkelja do të ndiqet penalisht.

Neni 69

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1335, datë 22.12.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha